



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ILIRJAN H. ISAJ  
ADRESA NR.5, BLV"BAJRAM  
CURRI", NR.25, NR.1, NR.2  
TEL: 682148021



# KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT

(KRIJIMI I QËNDRES)

Nr. repertori: 4038


Nr. koleksioni: 1066

Tirane më 26/12/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2020052590107726944



NOTER  
ILIRJAN H. ISAJ  
NUI: K31512001G TEL: 068 21 48



## AKTI THEMELIMIT TË QENDRËS

“MuZEH” Lab

### “QENDRA PËR ZHVILLIMIN E MUZEVE, TRASHËGIMISË dhe KULTURËS”

Sot, më datë 26.12.2020, para meje Noterit ILIRJAN H. ISAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, BLV"BAJRAM CURRI", NR.25, NR.1, NR.2, u paraqiten personalisht:

#### THEMELUESET:

1. **Dorina Subashi**, atësia Qamil, amësia Semiha, shtetase Shqiptare, lindur në Durrës dhe banuese në Durrës, me adresë Epikadeve 00690227; Nd. 12; H. 1; Ap. 9, 2025; Durrës, lindur më 16/04/1982, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. personal I25416073B, .

2. **Inesa Sulaj**, atësia Agim, amësia Enkelejda, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banuese në Tiranë, me adresë Gjon Nikolle Kazazi, Ndertese Private; Nd. Nr.21; Njësia Administrative Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 16/03/1995, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. personal J55316060R, .

Në mbështetje të Legjislacionit Shqiptar në fuqi ligjit nr . 8788 datë 03-05.2001 “ Për organizatat Jofitimprurëse” dhe ligjit nr. 8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” themelueset vendosën hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

#### Lloji dhe emri

##### Neni 1

Është themeluar Qendra “MuZEH” Lab, Qendra për zhvillimin e Muzeve, Trashëgiminë dhe Kulturën, [Center for the development of Museums, Heritage and Culture] (më poshtë referuar “Qendra”) një organizatë jofitimprurëse kulturore-shoqërore pa antarësi.

##### Neni 2

Qendra “MuZEH” Lab e ka selinë administrative në Durrës në adresën Lagja 4, Rr.Enver Zazani, banesë e ulët, Kati 1.  
Qendra e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me vendim të Bordit, Qendra mund të çelë degë brenda dhe jashtë vendit.

#### Identiteti i Themeluesit

##### Neni 3

Anëtarët themelues të Qendrës “MuZEH” Lab janë :

1. **Dorina Subashi**, atësia Qamil, e datëlindjes 16.04.1982, shtetase shqipëtare, lindur në Durrës dhe banuese në Durrës, paisur me Leternjoftimin ID I25416073B
2. **Inesa Sulaj**, atësia Agim, e datëlindjes 16.03.1995, shtetase shqipëtare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, paisur me Leternjoftimin ID J55316060R.

#### Qëllimet dhe fusha e veprimtarisë

##### Neni 4

Qendra ka për qëllim të veprimtarisë së saj:



Zhvillimin e aktivizimin e komunitetit e shoqërisë me kulturën dhe përdorimin e disiplinës së muzeologjisë e trashëgimisë kulturore dhe kulturës si forma ndërmjetësimi, nxitje e ndërveprim si hallka të zhvillimit e edukimit të shoqërisë nëpërmjet kulturës. Qendra formohet si një organizëm për të përcjellë vlera, ndërgjegjësim e bashkpunim me të rinjtë, profesionistët e kulturës, komunitetin e shoqërinë e për ti përfshirë ata si aktorë ndaj edukimit dhe mbrojtjes së vlerave kulturore lokale, kombëtare, rajonale e evropiane ndaj etiketimit si qytetarë evropian. Qendra vjen në një periudhë turbulencash kulturore në rrafsh global, evropian e rajonal ku kultura dhe marrëdhëniet me atë janë zbehur dhe ku domosdoshmëria për ta ripërirë atë pas kësaj krize pandemie është esenciale për mirëqënien sociale. Qendra MuZEH Lab, ka në thelb përfshirjen, advokimin, kujdesin dhe zhvillimin e muzeologjisë, trashëgimisë kulturore dhe kulturës dhe aktivizimin e komunitetit si pjesëmarrësit dhe përfituesit e parë, duke e konsideruar atë si qendër për/ dhe me komunitetin. Qendra është person juridik shqiptar dhe e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me këtë Statut.

*Kohëzgjatja*

*Neni 5*

Qendra krijohet me afat të pakufizuar. Kohëzgjatja mund të kufizohet me vendim të Bordit Drejtues dhe me pjesëmarrjen e shumicës, ashtu sikundër mund të zgjatet në të njëjtën mënyrë.

*Emri i personit që autorizohet të ndjekë procedurat*

*Neni 6*

Për ndjekjen e procedurave të nevojshme për regjistrimin e Qendrës në Gjykatën e ngarkohet av. Ilir Haznedari, dhe për përfaqësimin e saj ligjor me të tretët ngarkohet Drejtori Ekzekutiv, Znj. Dorina Subashi i datëlindjes 16.04.1982, lindur dhe banuese në Durrës.

*Neni 7*

Organi më i lartë vendimmarrës është Bordi Drejtues, një organizëm i përbërë prej 3 anëtarësh, në një periudhë të pakufizuar. Bordi Drejtues përbëhet nga Esmë Xheraj, Zarina Toto dhe Dorina Subashi.

*Neni 8*

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

### THEMELUESIT

Dorina Subashi

Inesa Sulaj

NOTER

ILIRJAN H. ISAJ

ILIRJAN H. ISAJ

NUIS: K31512001G TEL: 068 21 48 021 TIRANË